



ZYRA E KRYETARIT

01-351-8531/2026

26.03.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 70.18 të Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik , në bashkëpunim, dhe propozim të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe ZKA, merr këtë:

V E N D I M

Për

Emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejt të Menaxherit të Kontratës

Caktohet Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, për përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: **Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II. me operator; Lurn Ah.P.K., Rr. Ibrahim Krasniqi nr 10 Prishtinë dhe me numër të biznesit; 810084062.**

Me numër të prokurimit: 634-25-10539-5-2-1 dhe me numër të kontratës 04-2026, plani për implementimin e kontratës është 6 muaj.

Vlera e kontratës është 54.772.30 euro.

I. Luan Qezhinaj Menaxher i kontratës (Udhëheqës i ekipit) caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Gazmend Bojari Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Fitim Berisha Menaxher i kontratës caktohet:

Zyrtar në kuadër të Drejtorisë _____

Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës caktohet:

II. Agron Bacaj, Drejtor për Drejtorinë e Shendetësisë.

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës si dhe rregullave tjera të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe emërimit të Menaxherit të kontratës (MK) të gjitha përgjegjësitë përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit tek Menaxheri i Kontratës.

2. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës:

Menaxheri i kontratës do të:

- a. menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
- b. sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë dhe
- c. bëj vlerësimin e përformancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

Funksionet e Menaxherit të Projektit/kontratës janë:

- a. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxheri i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- b. Menaxheri i kontratës, duhet të lexoj kushtet e kontratës dhe të përgatis Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- c. Të dorëzoj Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyre të prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerr urdhër blerjen;
- d. Pas pranimit të urdhër-blejes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendos të dhënat në platformën elektronike, të ngarkoj në platformën elektronike urdhër-blejen dhe të përcjell të njëjtën përmes platformës tek OE, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- e. Të sigurojë që Operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- f. Të sigurojë që Operatori ekonomik të dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- g. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- h. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshtatshme;

- i. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- j. Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- k. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- l. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- m. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve
- n. Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe
- o. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontratë siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

3. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

Mbikëqyrësi drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për:

- a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
 - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të performancës së kontraktuesit - vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ .

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Prokurimit;
- Menaxherit të kontratës;
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës;
- Njesisë së Kërkesës;
- Arkivit të Komunës.

ZKA – KRYETARI

z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

01 Nr 351-8531/26

DATË 26.03.2026

KONTRATË 04-2026

Numri i kontratës:¹ 634-25-10539-5-2-1/C959

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëriën anë; dhe

LURN SH.P.K., Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, Prishtine, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Renovim dhe rindertim i hapsirave në QKMF dhe AMF faza II me numër identifikues: 634-25-10539-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Punë sipas paramases nga njesia kerkuse.**

No.	Lot
1	Renovim dhe rindertim i hapsirave në QKMF dhe AMF faza II

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **54,772.30 €**; Pesëdhjetë e katërmije e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy Euro e tridhjetë Cent.

2.2 Plani dinamik është 6 muaj

2.3 Sigurimi i ekzekutimit do të jete 5.477.20 Euro me validitet 6 muaj + 1 muaj=7 muaj

2.4 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Ne baze të situacioneve mbi kryerje të punimeve me Raport nga Organi Mbikëqyrës dhe Fature

- Mbajtja e parasë në vlerë 5.477.20 € do të paguhet pas Afatit të garancionit të punimeve mbas 12 muajve pas pranimit të përkohshëm teknik . Kjo mund të paguhet me garancinë nëse ekzistojnë mjete në dispozicion)

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Sigurimi i ekzekutimit

Plani dinamik

Menaxheri i kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të oken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26.03.2026
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	BURIM HASANI
Pozita:	MEHAKHOR
Nënshkrimi:	
Data:	26.03.2026
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

RENOVIMI I HAPËSIRAVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME TË QKMF-ve DHE					
Komuna Klinë					
QMF NE SFERRKE					
Poz.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Zhvendosja dhe bartja e inventarit të zyreve, koridoreve etj në një vend të caktuar nga AK si dhe kthimi në vende të mëparshme te vend caktimit nga menaxheri kontrates, pas përfundimit të renovimeve.Llogaria behet ne baze te siperfaqes se mbuluar me inventar.	m ²	80	3.00	240.00
2	.Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i murit e prej paneleve te gipsit të prodhuesit "KNAUF" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent "KNAUF i gjelbert" per perdorim me lageshti. Në kuader të këtij pozicioni duhet të përfshihen të gjitha elementet përcjellëse nga konstruksioni mbajtës metalik si: a) Arkerat se bashku më distancër, b) Profilet metalike mbajtëse L dhe U, si dhe te gjitha elementet e tjera përcjellëse. Panelet e gipsit duhet të vendosen nga të dyja anët si panele me trashësi t=12.5mm si dhe mes tyre te vendoset pambuk mineral. Llogaritja për m ² .	m ²	64	55.00	3520.00
3	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e murve ne hapersirat e brenshme me ngjyre plastifikuar kualitative dhe baze ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cnim te llogaritët edhe sanimi i kendeve te demtuara para se te behet ngjyrosja.	m ²	314	4.00	1256.00



4	Sanitimi I fasadave te jashtme. Në çmim të llogariten: demolimi I te gjitha shtresave te siperfaqes egzistuese, furnizimi dhe montimi I stiroporit N4(t=5-10cm), rrjetes sintetike, ngjitesit, fasades dhe ngjyres yndyrore si dhe montimi dhe demontimi I skeleve adekuate.	m ²	144	12.00	1728.00
5	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e derrasave ne strehen e objektit nga ana e jashtme me ngjyre kualitative dhe baze ngjyre, ngjyra percaltohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cmim te llogaritet edhe vendosja dhe largimi I skeleve.	m ²	14	20.00	280.00
6	Sigurimi, transporti dhe montimi i mbrojtëseve nga mediapaninë nivelin ~80cm mbi nivelin e shtresës së fundit të dyshemesë. Dimensionet 2x30 cm. Llajsnet duhet të jenë me kënde të rumbullakësuar me makinë zdrukthi. Në çmim përfshihet ljerja me ngjyre sipas kërkesës, shpimi I vrimave Ø8mm, montimi I vidave me tiplla Ø8mmx80mm qdo 1.5m.	m ¹	25	18.00	450.00
7	Furnizimi dhe montimi I dyerve nga PVC ne nyje sanitare. Te parashihet demolimi dhe largimi I dyerve te vjetra ne deponi.	Copë	4	350.00	1400.00

8	<p>Punizimi dhe montimi i xhamave te dritareve ekzistuese , demolimi i xhamit te thyer dhe zavendesimi me xham te ri .Hapësira për xham të dyfishtë min. 32 mm dhe pesha per kornizë 130kg. Izolim i përsosur zhurmash(mbi 52 dB) me tre seri guminash speciale (EPDM).Fibër e përforcuar poliamide (18 mm) per urën termike, ndërprerja termike anën ne shkallën min. (Uf=2.8W/m2K). Xhami 6mm (hapësira 14 mm mbushje gas argon) X 4mm transparent. Sistemi duhet te mbështet me certifikata dhe ateste adekuate për secilin pozicion.Me dimensione 50x50 cm.</p>	Copë	1	150.00	150.00
9	<p>Punimi i rampes per persona me aftesi te kufizuar nga konstrukioni metalik sipas standarteve ku lartesia e pushimores se shkalles 38 cm , gjersia mbi 120 cm me ramje deri ne 2 metera gjatesi.Te parashihet edhe gëlinderi mbrojtës ne dy anet .</p>	c	1	1200.00	1200.00

10	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi Ngrohës uji Elektrik 20 litra-vertikal, 2kW, 230V, mbrojtja IPX3 me ventil sigurus+termostai(komplet), prodhuesi ARISTON apo të ngjajshëm. Kjo pajisje duhet të përputhje me standardet e brendshme të sigurisë elektrike: IEC 60335-1 dhe IEC 60335-2-21. Shenja CE e pajisjeve vërteton konformitetin e saj me Direktivat e mëposhtme të KE-së, nga të cilat ajo plotëson kushtet thelbësore: Direktiva e tensionit të ulët LVD: EN 60335-1, EN 60335-2-21, EN 60529, EN 62233, EN 50106. Përputhshmëria EMC Elektro-Magnetike: EN 55014-1, EN 55014-2, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3. RoHS2 Rreziku i substancave të rrezikshme: EN 50581. Produktet e lidhura me energjinë ErP: EN 50440. Ky produkt duhet të përputhet me REACH. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi ne deponi.</p>	Copë	4	100.00	400.00
11	<p>Furnizim, montim me Panel 24W LED OG , te parashihet demolimi i panellave te vjeter.</p>	Copë	19	25.00	475.00
12	<p>Rregullimi i ores se rrymes , rregullimi dhe nderrimi i siguresave dhe lyerja e ormanit metalik me ngjyre antikoroduese.</p>	Copë	1	100.00	100.00
13	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i WC-ve guacave (lidhja ne muri me gypa te kanalizimit) së bashku me rezervuarin e ujit 6L-10L te montuar ne guacë dhe kroin për pastrim, guaca nga porcelani klasa e parë, dimensionet standarde për persona të rritur dhe pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni,. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi ne deponi.</p>	cope	2	45.00 €	90.00

14	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i Rubineteve(krojeve) mekanike për ujë të ftohët dhe të nxehtë hmin.=12cm, klasa e parë, 5 vite garanci. Në çmim të llogaritet aksesoret, pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Bateri të cilat vendosen në lavaman, Prodhusi KLUDI apo të ngjajshëm. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi ne deponi.</p>	copë	6	45.00 €	270.00
15	<p>Prodhimi, transporti dhe montimi i tavolines se punes me dimensione L/b/h=140/70/75cm. Tavolina duhet te jete e punuar nga materialet: Struktura mbajtese: Nga celiku i kualitetit te larte, e plastifikuar me ngjyre antikorodive dhe me RAL te percaktuar nga organi mbiqkyres. Paneli i siperm: Dru i kualitetit te larte "MDF" t=2x12mm, me teksture dhe dizajn te cilin e percakton organi mbiqkyres. N LLogaritja per copë</p>	m ²	2	550.00	1100.00

16	<p>Lartësia 100-118cm Gjersia 65cm Thellësia 51-73cm Lartësia e ulëses 44-57cm Gjerësia e ulëses 48cm Thellësia e ulëses 42-48cm Materiali: Duhet të jetë kualitativ me qëndrueshmëri të lartë që jep ndjesi dhe rehati shume të mirë ulëje, e cila është gjithashtu rezistente ndaj abrazionit (hargjimit) dhe e lehtë për tu pastruar. Duhet të përmbajë material me forcë të lartë me qëndrueshmërie afatgjatë, e cila mbanë ekuilibrin midis rehatisë dhe qëndrueshmërisë. Struktura e ulëses: Korniza e karrigës duhet të jetë e punuar nga çeliku i rëndë i klasës së lartë dhe jo korodiv si dhe më cilësor se çeliku i zakonshëm. Pllaka poshte ulëses poashtu duhet të jetë nga çeliku duktil si dhe mekanizmi për ulje -ngritje duhet të jetë i atestuar. Pesha maksimale bartëse duhet të jetë $Q \geq 150kg$.</p>	Copë	3	150.00	450.00
17	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i "Aparatit i kondicionimit të prodhuesit "Beko" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent me karakteristikat teknike si ne vijim: - Kapaciteti: 12000BTU - Niveli i operimit: -15OC deri +50OC - Teknologjia: Inverter - Klasa e energjise: A++ - Gas ekologjik - Funkcionaliteti: Auto Restart, Auto Mode, Turbo Mode, Soft Start, Sleep Mode, Timer etj. - Kapaciteti i ftohjes: 5100W - Kapaciteti i ngrohjes: 4000W. - Niveli i zhurmes: 56/60dB - Garancioni: Dy (2) vite.</p>	Copë	1	700.00	700.00

18	Pastrimi i hapësirës punuese dhe largimi i materialit në deponi pas përfundimit të punimeve.	komplet	1	150.00	150.00
TOTAL A					13959.00

B AMF NE GLLAREVE					
Poz.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Cmimi	Totali
1	Zhvendosja dhe bartja e inventarit të zyreve, koridoreve etj në një vend të caktuar nga AK si dhe kthimi në vende të mëparshme të vend caktimit nga menaxheri kontrates, pas përfundimit të renovimeve. Llogaria behet në baze të sipërfaqes së mbuluar me inventar.	m ²	30	3.00	90.00
2	Gërryerja e suvatimit të murit dhe pllafonit sipas nevojës deri në blloqe dhe në pllavon deri në beton duhet pasur kujdes që mos demtohet konstruksioni .	m ²	120	1.00	120.00
3	Sigurimi, transporti i bazës dhe punimi i lëvizjes me bazë me aftësi depërtimi të thellë në mure dhe tavane .	m ²	120	0.50	60.00
4	Furnizimi me material, transporti dhe punimi i lëvizjes me masë rrafshuesë, rrjetë, bazë gletë, 2 shtresa gletë .Se pari të rregullohen kendet me kendore sipas nevojës dhe udhëzimeve të organit mbikeqyres.	m ²	120	5.00	600.00

5	<p>Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i murit e prej paneleve te gipsit të prodhuesit "KNAUF" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent "KNAUF i gjelbert" per perdorim me lageshti.</p> <p>Në kuader të këtij pozicioni duhet të përfshihen të gjitha elementet përcjellëse nga konstruksioni mbajtës metalik si:</p> <p>a) Ankerat se bashku më distancër, b) Profilet metalike mbajtëse L dhe U, si dhe te gjitha elementet e tjera përcjellëse. Panelet e gipsit duhet të vendosen nga të dyja anët si panele me trashësi t=12.5mm si dhe mes tyre te vendoset pambuk mineral.</p> <p>Llogaritja për m².</p>	m ²	12	55.00	660.00
6	<p>Furnizimi me material dhe ngjyrosja e murve ne hapersirat e brendshme me ngjyrë plastifikuar kualitative dhe bazë ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cmim te llogaritet edhe sanimi i kenëve te demtuara para se te behet ngjyrosja.</p>	m ²	120	4.00	480.00
7	<p>Sanimi i fasadave te jashtme. Në çmim të llogariten: demolimi i te gjitha shtresave te sipërfaqes egzistuese, furnizimi dhe montimi i stiroporit N4(t=5-10cm), rrjetes sintetike, ngjitesit, fasades dhe ngjyres yndyrore si dhe montimi dhe demontimi i skeleve adekuate.</p>	m ²	55	18.00	990.00
8	<p>Furnizimi me material dhe ngjyrosja e derrasave ne strehen e objektit nga ana e jashtme me ngjyrë kualitative dhe bazë ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne çmim te llogaritet edhe vendosja dhe largimi i skeleve.</p>	m ²	18	15.00	270.00

9	<p>Sigurimi, transporti dhe montimi i mbrojtëseve nga mediapaninë nivelin ~80cm mbi nivelin e shtresës së fundit të dyshemesë. Dimensionet 2x30 cm.</p> <p>Llajset duhet të jenë me kënde të rrumbullakësuar me makinë zdrukthi. Në qmimi përfshihet lyerja me ngjyrë sipas kërkesës, shpimi i vrimave Ø8mm, montimi i vidave me tipla Ø8mmx80mm qdo 1.5m.</p>	m1	13	18.00	234.00
10	<p>Punimi i gilinderit për rapen e personave me aftësi të kufizuar sipas standartit.</p>	m1	3.5	100.00	350.00
11	<p>Furnizim, montim me Paneli 24W LED OG , te parashihet demolimi i paneilave te vjeter.</p>	Copë	6	45.00	270.00
12	<p>Rregullimi i ores se rrymes , rregullimi dhe nderrimi i siguresave dhe lyerja e cimanit metalik me ngjyre antikoroduese.</p>	Copë	1	150.00	150.00
13	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i WC-ve guacave (lidhja ne muri me gypa te kanalizimit) së bashku me rezervuarin e ujit 6L-10L te montuar ne guacë dhe kroit për pastrim, guaca nga porcelani klasa e parë, dimensionet standarde për persona të rritur dhe pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni, Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi ne deponi.</p>	cope	2	200.00 €	400.00

14	Furnizimi, transporti dhe montimi I Rubineteve(krojeve) mekanike për ujë të ftohët dhe të nxehtë hmin.=12cm, klasa e parë, 5 vjete garanci. Ne çmim te llogaritet aksesoret, pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Bateria të cilat vendosen në lavaman, Prodhuesi KLUDI apo të ngjajshëm. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi I te vjetres dhe largimi ne deponi.	cope	2	45.00 €	90.00
15	Demolimi I pllakave te keramikave ne hyrje te objektit dhe largimi I tyre ne deponi.	m ²	10.5	8.00	84.00
16	Furnizimi dhe vendosja e pllakave jo rreshqitese ne hyrje te objektit me lepak adekuat per temperatura te uleta dhe te larta .	m ²	10.5	55.00	577.50
17	Pastrimi I hapsires punuese dhe largimi I materialit ne deponi pas perfundimit te punimeve.	komplet	1	150.00	150.00
TOTAL B					5575.50

C QMF NE UJMIR					
Poz.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Zhvendosja dhe bartja e inventarit të zyreve, koridoreve etj në një vend të caktuar nga AK si dhe kthimi në vende të mëparshme te vend caktimit nga menaxheri kontrates, pas përfundimit të renovimeve. Llogaria bëhet ne baze te siperfaqes se mbuluar me inventar.	m ²	68	3.00	204.00

2	<p>Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i murit e prej paneleve te gipsit të prodhuesit "KNAUF" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent "KNAUF i gjelbert" per perdorim me lageshti.</p> <p>Në kuader të këtij pozicioni duhet të përfshihen të gjitha elementet përcjellëse nga konstruksioni mbajtës metalik si:</p> <p>a) Ankerat se bashku më distancër, b) Profilet metalike mbajtëse L dhe U, si dhe te gjitha elementet e tjera përcjellëse.</p> <p>Panelet e gipsit duhet të vendosen nga të dyja anët si panele me trashësi t=12,5mm si dhe mes tyre te vendoset pambuk mineral.</p> <p>Llogaritja për m².</p>	m ²	46.76	55.00	2571.80
3	<p>Furnizimi me material dhe ngjyrosja e murve ne hapësirat e brensëme me ngjyrë plastifikuar kualitative dhe bazë ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cmim te llogaritet edhe sanimi I kendeve te demtuara para se te behet ngjyrosja.</p>	m ²	272	4.00	1088.00
4	<p>Sigurimi,transporti dhe montimi i mbrojtëseve nga mediapaninë nivelin ~80cm mbi nivelin e shtresës së fundit të dyshemesë. Dimensionet 2x30 cm.</p> <p>Llajset duhet të jenë me kënde të rrumbullakësuzara me makinë zdruckthi.</p> <p>Në qmim përfshihet lyerja me ngjyrë sipas kërkesës, shpimi I vrimave Ø8mm, montimi I vidave me tiplla Ø8mmx80mm qdo 1.5m.</p>	m1	25	18.00	450.00
5	<p>Punimi I gilinderit per rapen e personave me aftesi te kufizuar sipas standartit.</p>	m1	5	150.00	750.00
6	<p>Furnizim, montim me Panel 24W LED OG , te parashihet demofimi I paneleve te vjeter.</p>	Copë	3	45.00	135.00

7	Furnizimi,transporti dhe montimi I WC-ve guacave(lidhja ne muri me gypa te kanalizimit) së bashku me rezervuarin e ujit 6L-10L te montuar ne guacë dhe kroin për pastrim,guaca nga porcelani klasa e parë,dimensionet standarde për persona të rritur dhe pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni,. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi I te vjetres dhe largimi ne deponi.	cope	2	200.00 €	400.00
8	Furnizimi,transporti dhe montimi I Rubinetave(krojeve)mekanike për ujë të ftohtë dhe te nxehtë hmin.=12cm,klasa e parë,5 vite garanci. Ne çmim te llogaritet aksesoret,pjesët lidhëse komplet dhe te gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion.Bateri të cilat vendosen në lavaman,Prodhusi KLUDI apo të ngjajshëm. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi I te vjetres dhe largimi ne deponi.	cope	2	45.00 €	90.00
9	Furnizimi dhe montimi I motorrit te ujit pe bashku me elementet perçjelles si dhe te parashihet hapja e kanalit deri 100 m , vendosja ekabulles 4x16 mm dhe mbulija e kanalit si dhe pjeset lidhese te motorrit.	komplet	1	850.00 €	850.00

10	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i "Aparatit i kondicionimit te prodhuesit "Beko" ose te ndonje prodhuesi ekuivalent me karakteristikat teknike si ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kapaciteti: 12000BTU - Niveli i operimit: -15OC deri +50OC - Teknologjia: Inverter - Klasa e energjise: A++ - Gas ekologjik - Funkcionaliteti: Auto Restart, Auto Mode, Turbo Mode, Soft Start, Sleep Mode, Timer etj. - Kapaciteti i ftohjes: 5100W - Kapaciteti i ngrohjes: 4000W. - Niveli i zhurmes: 56/60dB - Garancioni: Dy (2) vite. 	Copë	1	700.00	700.00
11	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i perdeve "Shiritore" me karakteristikat teknike si ne vijim: Materiali: Polyester i cili duhet te jete dyshtresore dhe me qendrueshmeri ndaj zjarrit. Ngjyra: Sipas kerkeses, bazuar ne katalog Mekanizmi: Draperi nga alumini nje kanatesh me tezhjekje ne litar dhe rruaza. Ne kuader te ketij pozicioni duhet te perfshihen te gjithe aksesoret percjelles. Demontimin e perdeve ekzistuese duhet t'a beje kontraktuesi nese kjo eshte e nevojshme.</p>	m ²	36	25.00	900.00
12	<p>Pastrimi i hapshires punuese dhe largimi i materialit ne deponi pas perfundimit te punimeve.</p>	komplet	1	150.00	150.00
TOTAL C					8288.80

D AMF NE CEROVIK					
Poz.	Pershkrimi i pozicioneve	Njesia	Sasia	Cmimi	Totali

1	Zhvendosja dhe bartja e inventarit të zyreve, koridoreve etj në një vend të caktuar nga AK, si dhe kthimi në vende të mëparshme të vend caktimit nga menaxheri kontrates, pas përfundimit të renovimeve. Llogaria behet në baze të sipërfaqes së mbuluar me inventar.	m ²	62	3.00	186.00
2	Grerëjtja e suvatimit të murit dhe pllafonit sipas nevojës deri në blloke dhe në pllavon deri në beton duhet pasur kujdes që mos demtohet konstruksioni .	m ²	123	0.30	36.90
3	Sigurimi, transporti i bazës dhe punimi i lyejës me bazë me aftësi depërtimi të thellë në mure dhe tavane .	m ²	123	0.50	61.50
4	Furnizimi me material, transporti dhe punimi i lyejës me masë rrafshuesë, rrjetë, bazë gletë, 2 shtresa gletë . Se pari të rregullohen këndet me këndore sipas nevojës dhe udhëzimeve të organit mbikëqyres.	m ²	123	8.00	984.00
5	Furnizimi me material, transporti si dhe punimi i murit e prej paneleve të gipsit të prodhuesit "KNAUF" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent "KNAUF i gjelbert" për përdorim me lageshti. Në kuader të këtij pozicioni duhet të përfshihen të gjitha elementet përcjellëse nga konstruksioni mbajtës metalik si: a) Ankerat së bashku më distancër, b) Profilët metalike mbajtëse L dhe U, si dhe të gjitha elementet e tjera përcjellëse. Pavelet e gipsit duhet të vendosen nga të dyja anët si panele me trashësi t=12.5mm si dhe mes tyre të vendoset parabuk mineral. Llogaritja për m ² .	m ²	51	45.00	2295.00

6	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e murve ne hapersirat e brendshme me ngjyre plastifikuar kualitative dhe baze ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cmim te llogaritet edhe sanimi i kendeve te demtuara para se te behet ngjyrosja.	m ²	123	4.00	492.00
7	Sanimi i fasadave te jashtme. Në çmim të llogariten: demolimi i te gjitha shtresave te sipërfaqes egzistuese, furnizimi dhe montimi i stiroporit N4(t=5-10cm), rrjetes sintetike, ngjitesit, fasades dhe ngjyres yndyrore si dhe montimi dhe demontimi i skeleve adekuate.	m ²	320	15.00	4800.00
8	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e derrasave ne strehen e objektit nga ana e jashtme me ngjyre kualitative dhe baze ngjyre, ngjyra percaktohet nga organi mbikqyres dhe investitori. Ne cmim te llogaritet edhe vendosja dhe largimi i skeleve.	m ²	96	12.00	1152.00
9	Furnizimi me material dhe montimi i soibankave të në anën e brendshme dhe jashte te ambijenteve nga mermeri natyral me trashësi 2,0 cm dhe me gjeresi deri 22,0cm. Soibanka duhet te ketë "kanalin" e pikores. Nuanca të percaktohet nga organi mbikqyres.	m	11	35.00	385.00
10	Sigurimi, transporti dhe montimi i mbrojtëseve nga mediapaninë nivelin ~80cm mbi nivelin e shtresës së fundit të dyshemesë. Dimensionet 2x30 cm. Llazsnet duhet të jenë me kënde të rrumbullakësuar me makinë zdrukthi. Në çmim përfshihet lyerja me ngjyre sipas kërkesës, shpimi i vrimave Ø8mm, montimi i vidave me tËppla Ø8mmx80mm qdo 1.5m.	m1	12	18.00	216.00

11	Furnizimi dhe montimi I çyerve nga PVC ne nyje sanitare.Te parashihet demolimi dhe largimi I çyerve te vjetra ne deponi.	Copë	2	350.00	700.00
12	Furnizimi dhe vendosja e pllakave jo rresqitese ne hyje te objektit me lepak adekuat per temperatura te uleta dhe te larta .	m ²	10.5	55.00	577.50
13	Furnizimi,transporti dhe montimi Ngrohës uji Elektrik 20 litra-vertikal, 2kW,230V,mbrojtja IPX3 me ventili sigurues+termostat(komplet),prodhuesi ARISTON apo të ngjajshëm.Kjo pajisje duhet të përputhje me standardet e brendshme të sigurisë elektrike: IEC 60335-1 dhe IEC 60335-2-21.Shenja CE e pajisjeve vërteton konformitetin e saj me Direktivat e mëposhtme të KE-së, nga të cilat ajo plotëson kushtet thelbësore: Direktiva e tensionit të ulët LVD: EN 60335-1, EN 60335-2-21, EN 60529, EN 62233, EN 50106. Përputhshmëria EMC Elektro-Magnetike: EN 55014-1, EN 55014-2, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3. RoHS2 Rreziku i substancave të rrezikshme: EN 50581. Produktet e lidhura me energjinë ErP: EN 50440. Ky produkt duhet të përputhet me REACH. Te parashihet edhe demolimi I te vjetres dhe largimi ne deponi.	Copë	4	110.00	440.00
14	Furnizim, montim me Panel 24W LED OG , te parashihet demolimi I panellave te vjeter.	Copë	3	35.00	105.00
15	Rregullimi I ores se rrymes , rregullimi dhe nderrimi I siguresave dhe lyetja e ormanit metalik me ngjyre antikoroduese.	Copë	1	100.00	100.00

16	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i WC-ve guacave (lidhja në muri me gypa të kanalizimit) së bashku me rezervuarin e ujit 6L-10L të montuar në guacë dhe kroit për pastrim, guaca nga porcelani klase e parë, dimensionet standarde për persona të rritur dhe pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për kompletimin e këtij pozicioni. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi në deponi.</p>	cope	2	200.00 €	400.00
17	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i Rubinetave (krojeve) mekanike për ujë të ftohët dhe të nxehtë hmin.=12cm, klase e parë, 5 vite garanci. Në çmim të llogaritës aksesoret, pjesët lidhëse komplet dhe të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Bateri të cilat vendosen në lavaman, Prodhuesi KLUDE apo të ngjajshëm. Llogaria bëhet për copë. Te parashihet edhe demolimi i te vjetres dhe largimi në deponi.</p>	cope	2	45.00 €	90.00
18	<p>Prodhimi, transporti dhe montimi i tavolines së punës me dimensione L/b/h=140/70/75cm. Tavolina duhet të jetë e punuar nga materialet: Struktura mbajtëse: Nga çeliku i kualitetit të lartë, e plastifikuar me ngjyrë antikorodive dhe me RAL të përcaktuar nga organi mbikqyres. Paneli i sipërm: Dru i kualitetit të lartë "MDF" t=2x12mm, me teksture dhe dizajn të cilin e përcakton organi mbikqyres. N Llogaritja për copë</p>	m ²	2	450.00	900.00

19	<p>Lartësia 100-118cm Gjersia 65cm Thellësia 51-73cm Lartësia e ulëses 44-57cm Gjerësia e ulëses 48cm Thellësia e ulëses 42-48cm Materiali: Duhet të jetë kualitativ me qëndrueshmëri të lartë që jep ndjesi dhe rehati shumë të mirë ulëje, e cila është gjithashtu rezistente ndaj abrazionit (hargjimit) dhe e lehtë për t'u pastruar. Duhet të përmbajë material me forcë të lartë me qëndrueshmëri afatgjatë, e cila mbanë ekuilibrin midis rehatisë dhe qëndrueshmërisë. Struktura e ulëses: Korniza e karrigës duhet të jetë e punuar nga çeliku i rëndë i klasës së lartë dhe jo korodiv si dhe më cilësor se çeliku i zakonshëm. Pllaka poshtë ulëses poashtu duhet të jetë nga çeliku duktil si dhe mekanizmi për ulje -ngritje duhet të jetë i atestuar. Pesha maksimale bartëse duhet të jetë $Q \geq 150\text{kg}$.</p>	Copë	3	120.00	360.00
20	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i "Aparatit i kondicionimit të prodhuesit "Beko" ose të ndonjë prodhuesi ekuivalent me karakteristikat teknike si në vijim: - Kapaciteti: 12000BTU - Niveli i operimit: -15OC deri +50OC - Teknologjia: Inverter - Klasa e energjise: A++ - Gas ekologjik - Funkcionaliteti: Auto Restart, Auto Mode, Turbo Mode, Soft Start, Sleep Mode, Timer etj. - Kapaciteti i ftohjes: 5100W - Kapaciteti i ngrohjes: 4000W. - Niveli i zhurmes: 56/60dB - Garancioni: Dy (2) vite.</p>	Copë	1	550.00	550.00

21	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i perdeve "Shinitore" me karakteristikat teknike si ne vijim: Materiali: Polyester i cili duhet te jete dyshtresore dhe me qendrueshmeri ndaj zjarrit. Ngjyra: Sipas kerkeses, bazuar ne katalog Mekanizmi: Draperi nga alumini nje kanalesh me terheqje ne litar dhe rruaza. Ne kuader te ketij pozicioni duhet te perfshihen te gjitha aksesoret percejelles. Demontimin e perdeve ekzistuese duhet ta beje kontraktuesi nese kjo eshte e nevojshme.</p>	m ²	21	25.00	525.00
22	<p>Sanimi i rrethojave me profile metalike . Duhet te behet saldimi i profileve metalike te ndryshme te shkoqitura nga vendi si dhe drejtimi i profileve te cilat ka mundesi teknikisht qe te drejtohen. Ne qmim te llogaritit edhe materiali shpenzues per saldim. Çmimi llogaritit sipas siperfaqes se rrethojes ne te dy anet e saj.</p>	m ²	175.5	12.00	2106.00
23	<p>Furnizimi, transporti i ngjyres dhe lyerja e rrethojave metalike .Lyerja te behet me parangjyre dhe ngjyre metalik kualtative. Verejtje: Para ngjyrosjes te behet mire gerryerja e siperfaqeve metalike deri ne largimin e teresishem te ngjyres paraprake dhe mases korodive. Çmimi llogaritit sipas siperfaqes se rrethojes ne te dy anet e saj.</p>	m ²	175.5	4.00	702.00
24	<p>Furnizimi ,montimi dhe saldimi i profileve metalike te deres hyrse ne oborre , te behete funksionale.</p>	Cope	1	180.00	180.00
25	<p>Pastrimi i hapsires punuese dhe largimi i materialit ne deponi pas perfundimit te punimeve.</p>	komplet	1	250.00	250.00
TOTAL D					18593.90

REKAPITULIM

REKAPITULIM		
A	QMF NE SFERRKE	13959.00
B	AMF NE GLLAREVE	5575.50
C	QMF NE UJMIR	8288.80
D	AMF NE CEROVIK	18593.90
GJITHESEJT PA TVSH		46417.20
TVSH 18 %		8355.10
GJITHESEJT ME TVSH		54772.30



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 634-25-10539-5-2-1/C959

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Në gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk rreth lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoritetit kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfundim të obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthejë autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdherat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë në Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktiket, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të privet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastiit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të rëndësishme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzimin dhe miratimin të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërrhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përfunduar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vlerëtimin të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesit.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritset se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca mëdhorë të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrës dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskoje garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bifancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasimore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimeve e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimeve e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modellet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia të riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuase të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe njështëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së fillit. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bërë të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 PAGESA

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguajë Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vendpunim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vendpunim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK, nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtrëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënis është përdorur në këto mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shuma në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet t'i paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqet për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të dhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i implantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshhtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tjilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përvçq masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me përkrahjen e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimin të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjalur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpiqet shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punim dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozilën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrim i në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 634-25-10539-5-2-1/C959

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 5.477.20 EURO me validitet 6+1=7 muaj.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>Përgjegjësi e operatorit ekonomik</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>Përgjegjësi e operatorit ekonomik</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>Përgjegjësi e operatorit ekonomik</i> (d) dëmtim personal ose vdekje: i. të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[Përgjegjësi e operatorit ekonomik]</i> ii. të personave të tjerë: <i>Përgjegjësi e operatorit ekonomik</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>[me të pranuar të dy anët nga menaxheret e kontratës nga të dy palët]</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 6 muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 100 %] e Çmimit final të Kontratës..

Regjistri i punës	20.1	<i>ditari i punëve</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>[shëno emrin, adresën e Menaxherit të Projektit]</i> .
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: ska
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>10% e vlerës së kontratës</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>3</i> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <i>365</i> ditë,
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Me pajtueshmëri të dy anshme</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata themelore Peje dega Kline në pajtim me ligjin në Kosovë.


Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: Lurn shpk deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Lurn shpk
Adresa e plotë:	rr.Ibrahim Krasniqi nr 10 Prishtine
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Besart Hasanaaj
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	09.12.2025
Vula:	





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT TË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU I BIZNISA
AGENCIJA ZA REGISTRACIJU I BIZNISA

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810084062

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

LURN SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Poslovni tip: Društvo sa ograničenom odgovornošću
Business type: Limited Liabilities Companies

Adresa: Rruga Ibrahim Krasniqi, 10
Adresa: Prishtinë
Address:

Data e regjistrimit: 11/01/2018
Datum registracije:
Date of registration:

04/11/2022

Data / Date / Datum



Stecaj

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10150450



ÇERTIFIKATË - DEKLARUES I TVSH
UVERENJE - DBVEZNIK ZA PDV
CERTIFICATE - VAT-FILER

Numri
Broj
Number

330376732

Numri Fiscal
Fiskalni Broj
Fiscal Number

810084062

Emri i personit
Ime osebe
Person's Name

"LURN" SH.P.K.

Adresa e Personit
Adresa osebe
Person's Address

RRUGA IBRAHIM KRASNIQI, 10 PRISHTINË PRISHTINË KOSOVA

Data e Regjistrimit
Datum Registracije
Registration Date

12-01-2018

Data e Lëshimit
Datum Izdavanja
Date of Issuance

22-05-2023

Personi Përgjegjës
Odgovorno Lice
Responsible Person



Kjo certifikatë është lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar.
Ovaj certifikat izdat je od Poreske Administracije Kosova, shodno Zakonu Br. 05/L-037 O Porezu na Dodanu Vrednost.
This certificate is issued by the Tax Administration of Kosovo, based on the Law Nr. 05/L-037 on Value Added Tax.



LRP nr. 4704/2024

-----VËRTËTIM I KOPJES SË ORIGJINALIT-----

Astrit S. Bibaj, noter në Prishtinë, Rruga "Garibaldi" nr.15/5, vërteton se:-----
Kopja e dokumentit që i prinë tekstit, e verifikuar nga noteri, në të gjitha pikëpamjet është konform kopje identike me origjinalin e sjellë nga pala:-----
z. z. **MASAR KABASHI**, i lindur me datë: **07/01/1980**, (shtatë janar një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) në: Istog, bartës i dokumentit të identifikimit të lëshuar nga MPB-RKS, me nr. personal: **1005784138**, lëshuar nga MPB-RKS, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.-----

Dokumenti: **Certifikatë**, lëshuar nga: **Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Republika e Kosovës**, për biznesin "LURN" SH.P.K, e sjell nga pala është prezantuar si origjinal dhe noteri, nuk merr përgjegjësi për përmbajtjen e këtij dokumenti dhe informatat që ka dokumenti dhe pala garanton për vërtetësinë e tyre.-----

Veprimi i noterizimit u bë në Prishtinë, në zyrën e noterit, me datë: dhjetë qershor dy mijë e njëzet e katër (10.06.2024). h 09:52 -----

Dokumenti i sjellë nga pala është fotokopjuar në zyrën e noterit, ka 1 faqe, është vërtetuar në 2 kopje-ekzemplar, dhe është paguar në shumën prej 2 € + 10 cent për faqe + TVSH në bazë të nenit 29, dhe neni 42 pika nr. 1 konform U.A. për Tarifat Noteriale nr. 05/2022.-----

Noteri

Astrit S. Bibaj





VËRTETIM TATIMOR TAX VERIFICATION PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:

Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:

Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:



1001302388

Emri i personit:
Name of Person: " LURN " SH.P.K.
Ire lice:

Numri Identifikues Personal:
Personal Identification Number:
Identifikacioni Liçni Broj:

Numri Fiskal:
Fiscal Number: 810084062
Fiskałni Broj:

Komuna:
Municipality: PRISHTINË
Opština:

Data:
Date: 05.12.2025
Datum:

Arsyeja e lëshimit:
Reasoning: Aplikim për Tender
Razlog izdavanja:

ka këtë gjendje tatimore në ATK:

has the following tax position with the TAK:

ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova potvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit
The verification is valid for 90 days from the day it is issued
Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -

Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:

<https://eVrtetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer>



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD - COMMERCIAL COURT

Nr.ser. A.GJ.8405/2025
Ser.br.
Ser.no.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, në kuptim të nenit 43, paragrafi 3 dhe 6 të Rregullores Nr.17/2024 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, të datës 05.12.2024, duke vepruar sipas kërkesës së palës, lëshon këtë:

CERTIFIKATË

Numri unik identifikues:	810084062
Emri i personit juridik:	LURN SH.P.K.
Emrat e mëparshëm (nëse ka):	/ /
Emri tregtar:	
Lloji i personit juridik:	SH.P.K.
Selia e personit juridik:	Prishtinë

Në regjistrat e Gjykatës Komerciale të Kosovës, për shoqëri të tregtare me të dhënat si më lart, **NUK KA** evidencë se është iniciuar/hapur procedura e falimentimit.

Kjo Certifikatë do të përdoret për: Tender

Mëshkruesi/Potpisnik/Signatory	KGJK/SSK/KJC	
Data/Datum/Date	26/11/2025	
Referenti/ Referent/ Clerk (Emri i përdoruesit) Afrim Ademi		

Plani Ditearrik 6 Muaj per kryerjen e punimeve

ID	Task Made	Task Name	M	T	W	T
1	MP	Renovim dhe rindërtim i hapësirave ne QKMF dhe AMF Iaza H634-25-10539-S-2-1				
2	MP	QMF NE SFERRKE				
3	MP	AMF NE GILAREVE				
4	MP	QMF NE UJIMIR				
5	MP	AMF NE CEROVIK				

Project: Project1
Date: Tue 12/17/2025

Task Summary

Inactive Summary

Manual Task

Duration-only

Manual Summary Rollup

Project Summary

Inactive Task

Inactive Milestone


External Tasks

External Milestone

Deadline

Progress

Manual Progress





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E TENDERIT

Pjesë përbërëse e Policës me Nr. 146798

Për **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **LURN SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Renovim dhe rindertim i hapsirave në QKMF dhe AMP faza B**

Nr. prokurimit: 634-25-10539-5-2-1, Nr. brendshëm: ..

Garancion me kërkesë të parë

Densa operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të tenderit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale, **1,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmimeve të vertetuara objektivisht se tenderuesi i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese autoritetit kontraktues
- Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzimin të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në dosje të tenderit
- Tenderuesit iu është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi e refuzon apo dëshnon:
 - Që të depozitoi sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në dosje të tenderit
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në dosjen e tenderit
 - Të lidhë kontratë që u përshtatet afatave dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit

Pagesa në shumën e limituar prej **1,000.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 60 ditë kalendarike prej **09.12.2025** deri më **07.02.2026**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për të rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishtme të detyrimeve.

Data lëshimit: 09.12.2025

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshkrohet mequllave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.

Ne baze te tenderit te shpallur nga Komuna e Klines per tenderin me titull : Me
titull "Renovim dhe rindertim i hapësirave ne QKMF dhe AMF faza II dhe nr 634-25-
10539-5-2-1

Kompania Lurn shpk jep kete:

Deklaratë për specifikime teknike


Kompania Lurn shpk deklaron se do bejme pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K, garanton se punët dhe materialet që do të përdoren do të jenë kualitative dhe në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Te gjitha shërbimet do të ofrohen sipas Specifikave teknike të Aneksit 1 të DT-së.

Prishtine,09.12.2025

Ne emer te kompanise:

Lurn shpk

Besart Hasanaj-Direktor





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **148903**

Për **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **LURN SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II**

Nr. prokurimit: 634-25-10539-5-2-1 , Nr. brendshëm:

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **5,477.23€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **5,477.23€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 217 ditë kalendarike prej **25.03.2026** deri më **28.10.2026**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 25.03.2026

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.